



**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë / /2025

1

Sikurse jeni në dijeni institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit z. V. G. për moszgjidhjen e situatës si debitor të shkaktuar që në tetor të vitit 2022 nga punonjësit e operatorit që ofrojnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

Sipas shpjegimeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi, z. V. G. me familjen e tij banojnë në fshatin Livadhja, në Njësinë Administrative Livadhja, Bashkia Finiq. Në vitin 2004 ankuesi, ka ndryshuar mbiemrin nga V. M. në V. G. dhe në vitin 2005 ka bërë ndryshim të emrit nga B.B në V.G., por që në sistemin e FSHU-së vazhdon të figurojë me emrin B. B.. Si abonent identifikohet me kod klienti GJ0B030015xx dhe nr. kontrate B-04xxx.

Në muajin tetor 2022 (në datën 11.10.2022), pa prezencën e tij dhe të asnjë prej familjarëve të tij, punonjës të operatorit që kryen shërbimin me furnizimin e energjisë elektrike kanë ndërruar matësin e energjisë elektrike. Mosprania e z. V.G. në banesë ka qenë për faktin se, ankuesi, është banues edhe në Greqi por pagesat e detyrimeve të furnizimit me energji elektrike, edhe pse minimale me një konsum i cili nuk i kalon 8 kWh në muaj, i ka paguar rregullisht. (vërtetuar nga kopje e librezës së energjisë elektrike dorëzuar si dokument provues nga z.V.G.)

Ankuesi z. V.G. nga pagesa minimale që kryente më herët, nga momenti i ndërrimit të aparatit matës në datën 11.10.2022, rezultoi me një konsum energjie prej 4278kWh. Në muajin dhjetor 2022, z. V.G. paraqitet pranë zyrave të Kujdesit Ndaj Klientit për të bërë ankesë lidhur me nxjerrjen debitor dhe për faktin se i është bërë ndërrimi i aparatit matës në banesën e familjes së tij pa prezencën e askujt. Në përgjigje të kësaj ankese, FSHU Sarandë sh.a me shkresën nr.341 prot., datë 23.01.2023, “Kthim përgjigje” sqaron ankuesin se: *“ Më datë 11.10.2022 u realizua ndërrimi i matësit në sistemin matës me numër serie 8027374-2010 që furnizon kontratën me numër GJ0B030015xxx. Nga verifikimi i kryer, matësi rezultoi i rregullt nga ana vizuale, me gjendje leximi 4278kWh. Referuar sistemit të faturimit vërejmë se leximi i matësit i hedhur në muajin tetor 2022 është 4278 kWh. Leximi i matësit përkon me gjendjen në sistemin e faturimit. Pra, ju jeni faturuar sipas gjendjes reale në matësin tuaj.”*

Por megjithatë, z. V.G. shkruan se nuk ka arritur të zgjidhë këtë parregullsi të krijuar e cila e ka nxjerrë debitor, në këto rrethana ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Së bashku me ankesën/kërkesën e tij të paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, z. V.G. ka paraqitur si prova, ndër të tjera, dokumentet si vijon:

- 1- Detajet e Klientit, shoqëruar me Tabelën e Konsumit të Energjisë Elektrike, për vitin 2022 (që është dhe objekt i ankesës së tij)
- 2- Faturë Tatimore 30.08.2022
- 3- Faturë Tatimore 30.09.2022
- 4- Faturë tatimore (Faturë sistemuese – notë debiti) 24.10.2022
- 5- Librezë e energjisë elektrike

Referuar sa më sipër, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe nenit 19 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a Sarandë, Drejtorisë Rajonale Gjirokastër të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a Tiranë me shkresën nr. K3/V13-4 prot., datë 06.11.2024 “Kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion”.

Në përgjigje tonës, me shkresën nr.7081/1 prot., datë 10.12.2024 Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. Tiranë sqaron se: “...Departamenti i Marrëdhënieve me Klientin në bashkëpunim me strukturat përkatëse mori masat për ndjekjen dhe shqyrtimin e rastit. Referuar dokumentacionit të ndryshimit të matësit, të cilin e gjeni bashkangjitur, rezulton se në datë 11.10.2022 për kontratën GJOB030015xxx, është demontuar matësi me numër serie 8027374 me gjendje në momentin e demontimit 4278 kWh dhe është montuar matësi i ri me numër serie 22116564 me gjendje në momentin e montimit 0 kWh. Të dhënat e matësit të ri janë menaxhuar në sistem në muajin tetor në datën 24.10.2022. Për rrjedhojë, në muajin tetor 2022 është gjeneruar fatura sistemuese me numër serie 440471732, në sasinë 3678 kWh, ku është faturuar gjendja nga matësi i demontuar (4278 kWh gjendja e demontimit – 600 kWh leximi në muajin shtator 2022 = 3678 kWh konsum i pafaturuar), Gjithashtu, në muajin tetor 2022, është gjeneruar fatura me numër serie 441406399, ku është faturuar konsumi i regjistruar në matësin e ri me numër serie 22116564 për periudhën 30.09.2022 – 31.10.2022.”

Shkresa e mësipërme e FSHU-së është shoqëruar me një sërë dokumentash si:

- 1- Procesverbal datë 11.10.2022 për ndërrimin e matësit të energjisë elektrike, firmosur vetëm nga anëtarët e ekipit të FSHU-së
- 2- Foto të aparatit matës të vjetër të demontuar
- 3- Foto të aparatit të ri elektronik të montuar
- 4- Faturë tatimore sistemuese datë 24.10.2022
- 5- Faturë tatimore datë 31.10.2022
- 6-Detajet e Klientit
- 7-Leximi i konsumimit të energjisë të Klientit
- 8-Customer Payment Details

Sa më lart, konstatojmë një qëndrim aspak të drejtë të FSHU sha ndaj abonentit sa i përket procedurës së njoftimit të ankuesit, dhe po ashtu edhe lidhur me faturimin e padrejtë, të ankuesit, të justifikuar si notë debiti.

Në pikën 3, të nenit 76 “Matja e energjisë elektrike”, të ligjit nr.43, datë 30.04.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se: “Energjia elektrike e hedhur në

rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë...”

Në rastin konkret, zëvendësimi i matësit të energjisë elektrike të Klientit V.G. është bërë me iniciativën e OSSH dhe si rrjedhojë shpenzimet e zëvendësimit të matësit janë mbuluar nga vetë OSSH, kjo në zbatim të Kodit të Matjes, pika “IV.2.3 Zëvendësimi i Matsave”¹. Gjithashtu, në rastet kur klienti paraqet një kërkesë për verifikim të saktësisë së matësit elektrik në përdorim të tij, Operatori i Rrjetit kryen shërbimin në bashkëpunim me subjektin e autorizuar dhe në prezencë të klientit². Kjo nuk do të thotë që ky kusht të jetë i pazbatueshëm në rastet kur zëvendësimi i matësit bëhet me iniciativë të OSSH. Vetë modeli i Procesverbalit i përdorur nga OSSH në rastin konkret, procesverbali me nr serial: 1089345, me datë kryerje verifikimi/sistemimi 11.10.2022 dhe datë marrje në dorëzim nga data analist 11.10.2022, në fund përmban hapësirën ku duhet nënshkrimi nga Abonenti, i cili mungon pasi z. V.G. nuk ka qenë në dijeni të mbajtjes së këtij procesverbali dhe nuk ka qenë prezent ndërkohë që Anëtarët e ekipit, të cilët kanë konstatuar dhe kryer zëvendësimin e matësit të energjisë rezultojnë të kenë firmosur.

Lidhur me matjen e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar të matur sipas sistemit mPower, konstatohet se ka një mospërputhje nga çfarë FSHU ka sqaruar dhe asaj çfarë realisht ka konsumuar Klienti si energji elektrike.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga z. V.G. , kopje e librezës së energjisë elektrike e firmosur nga punonjësi i sportelit ku është kryer pagesa, faktohet se ai ka paguar vlerat për konsumin e energjisë elektrike për muajt:

- maj 2022 totalin prej 111 lekë; qershor 2022 totalin prej 340 lekë; korrik 2022 totalin prej 340 lekë; gusht 2022 totalin prej 772 lekë; shator 2022 totalin prej 340 lekë; tetor 2022 totalin prej 340 lekë; nëntor 2022 totalin prej 122 lekë; dhjetor 2022 totalin prej 145 lekë.

Pra, vërehet se përgjatë muajve abonenti, z. V.G., ka një konsum minimal të energjisë elektrike, nga e cila kuptohet lehtësisht që ai nuk ka qenë fizikisht në banesë, pasi kjo përkon me periudhën në të cilën ai ndodhet në Greqi.

Në këtë llogjikë është edhe Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, në Studimin e Konsumit të Energjisë Elektrike në Familjet³ ku për analizën e disa treguesve është shprehur se: *“Duke shqyrtuar të dhënat e kësaj tablele të tërheq vëmendjen fakti që x konsumatore familjare ose x% e numrit të përgjithshëm të tyre nuk kanë fare konsum mujor. Një gjë e tillë shpjegohet me*

¹ https://infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Kodi_i_Matjes_Vendim_nr.101_date_26.8.2008.pdf

² Shih Nenin 7 të Rregullores së paraqitjes së një kërkesë, miratur me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.145, datë 18.09.2017

https://www.ere.gov.al/doc/RREGULLORJA_MBI_PROCEDURAT_PER_PARAQITJEN_E_NJE_KERKES_E_SHQYRTIMIN_E_SAJ_DHE_AFATET_E_NJOFTIMIT_KUR_KLIENTI_DYSHON_NE_SAKTESINE_E_TE_DHENAVE_TE_APARATIT_MATES_TE_ENERGJISE_ELEKTRIKE-2.pdf

³ Studim i bërë nga Enti Rregullator të Sektorit të Energjisë (faqe 15) https://ere.gov.al/doc/Studimi_Konsumi_i_Energjise_Elektrike_ne_Familje_4.09.2009.pdf

faktin se të njëjtët konsumatorë mund të kenë dy banesa, një verore të cilën e shfrytëzojnë periodikisht për pushime dhe tjetrën për banim, po ashtu është evidentuar një numër i konsiderueshëm banesash të pabanueshme, të rrënuara, por që nuk janë evidentuar në regjistrin e faturimeve si dhe banesa të emigranteve, të mbyllura dhe pa konsum energjie”.

Nga dokumenti i paraqitur nga ankuesi dhe FSHU, në të dhënat e sistemit të mPower, matja e konsumit të energjisë elektrike të konsumuar nga Klienti z. V.G. , rezulton me të dhënat për faturat e lëshuara, si vijon:

Muaji	Data e leximit	Leximi i mëparshëm energji aktive kWh	Leximi aktual energji aktive kWh	Konsumi energji aktive kWh
Mars	28.03.2022	4275	4276	1
Prill	27.04.2022	4276	4277	1
Maj	27.05.2022	4277	4277	0
Qershor	27.06.2022	4277	4277	0
Korrik	27.07.2022	4277	4277	0
Gusht	30.08.2022	4277	600	
Shtator	30.09.2022	600	600	
Tetor	24.10.2022	600	4278	3678
Tetor	31.10.2022	0	0	
Nëntor	27.11.2022	0	2	2
Dhjetor	29.12.2022	2	6	4
Janar	28.01.2023	6	9	3
Shkurt	26.02.2023	9	12	3
...	...	...	...	...
Shtator	27.09.2023	151	195	44
Tetor	28.10.2023	195	291	96
...	...	...	...	...
Prill	28.04.2024	1111	1143	32
Maj	27.05.2024	1143	1144	1

Vetë tabela⁴ tregon qartazi se në muajin gusht 2022 sistemi ka bërë matje në mënyrë regresive. Theksojmë se, konsumi i përlllogaritur ndër vite në aparatin matës fizik të konsumit të energjisë elektrike i instaluar në banesën e z. V.G. , në datën 27.07.2022 ka arritur vlerën 4277 kWh, vlerë që përkon dhe me matjen e konsumit në sistemin mPower. Ndërsa në datën 30.08.2022 ky konsum regredon, pakësohet, duke arritur në vlerën 600 kWh sipas të dhënave të sistemit matës elektronik në përdorim të shoqërisë që ofron furnizimin e shërbimit universal me energji elektrike. Pra, në rastin konkret ka një matje inverse të logjikës së ndjekur ndër vite nga sistemi mPower, ndërkohë që në aparatin matës fizik të instaluar në banesën e abonentit leximi i konsumit rezulton ende 4277 kWh. E njëjta vlerë regjistrohet edhe në datën 30.09.2022, në sistemin mPower, pra 600 kWh. Ndërsa më datë 24 tetor 2022, në sistemin mPower, bëhet leximi me 4278 kWh (pra rikthehet në vlerat e matura në datën 27.07.2022) që përkon me leximin e matësit fizik të konsumit të energjisë elektrike në banesën e abonentit. Më tej nga

⁴ Tabelë e draftuar në këtë rekomandim nga institucioni i Avokatit të Popullit

muaji nëntor 2022 regjistrimi dhe leximi i konsumit të energjisë elektrike për abonentin, z. V.G., në sistemin mPower vijon në mënyrë progresive, pra numërim në vlerë rritëse e konsumit të energjisë elektrike.

Rikujtojmë se data e procesverbalit për kryerjen e verifikimit dhe të dhënat e sistemit të matjes pas verifikimit/sistemimit/montimit të matësit të ri (me index exportit aktive 1.8.5 kWh/njësi 000000.00) mban datën 11 tetor 2022.

Pra, sikurse rezulton edhe nga tabela më sipër, përgjatë muajve mars-gusht 2022, konsumi i energjisë aktive ka qenë në total 2 kWh, ndërkohë që çuditërisht në muajin tetor 2022 ky konsum i energjisë aktive rezulton në 3678 kWh, çka nuk justifikon gjendjen aktuale të abonentit dhe konsumin e sasisë së energjisë elektrike prej këtij abonenti. Edhe pas periudhës tetor 2022, konkretisht në muajt nëntor dhe dhjetor 2022, vlerat e konsumit të energjisë elektrike rikthehen në vlera normale respektivisht në 2 dhe 4 kWh.

Neni 6, i Rregullores së miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.145, datë 18.09.2017⁵, parashikon: *“Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim dhe çdo term tjetër i parashikuar në këtë rregullore do ketë kuptimin e termave të përcaktuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjin Nr.9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar... “Kodi i Matjes” është tërësia e rregullave teknike dhe normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e Energjisë Elektrike, me qëllim matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike. “Matës energjie” janë aparate matëse që masin energjinë elektrike nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike në lidhje me kohën respektive.”*

Nga sa rregulluar me akte nënligjore të ERE, në rastin konkret “Kodi i Matjes” dhe “Matës energjie” humbasin kuptimin e përkufizimit të tyre, pasi nuk rezulton që për rastin e ankuesit z. V.G. në sistem të pasqyrohet matja apo hyrja në sistem më datë 11.10.2022 e matësit të ri me lexim energji aktive 0. Por, ky veprim në sistem është reflektuar më datë 31.10.2022.

Më tej, në shkresën nr.7081/1 prot., datë 10.12.2024, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, në kuadër të hetimit administrativ, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. Tiranë, sqaron se më datë 24.10.2022 është gjeneruar faturë sistemuese. Lidhur me këtë shpjegim që është dhënë nga ana juaj, vlerësojmë se në kuptim të termit të gjuhës teknike që përdoret në matjen e konsumit të energjisë elektrike, konsumi i faturuar (i cili është pjesë përbërëse e përlllogaritjes së konsumit faktik) për muajin maj 2022, energjia aktive e konsumuar është 1 kWh dhe detyrimi për t’u paguar është në totalin prej 111 lekë. Ndërsa për muajin gusht 2022, ku numërimi i konsumimit të kWh nga 4277 kWh ka zbritur në 600 kWh, pa tregues difference të konsumit të energjisë aktive, është përlllogaritur detyrimi për t’u paguar në totalin prej 772 lekë. Pra, nuk është e qartë se si kjo vlerë është përlllogaritur, sepse nuk rezulton asnjë konsum i energjisë aktive. Edhe në muajin shtator 2022 konsumi i energjisë elektrike është regjistruar me 600 kWh, pa diferencë të konsumit të energjisë aktive dhe është përlllogaritur detyrimi për t’u paguar në totalin prej 340 lekë (240 lekë principlali +100 lekë TV tax).

⁵[regullorja mbi procedurat per paraqitjen e nje kerkese shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon ne saktesine e te dhenave te aparatit mates te energjise elektrike-2.pdf](#)

Pas montimit të matësit të ri në datën 11.10.2022, me nr serie 22116564, model elektronik, me index exportit 0 kWh, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, në datë 24 tetor 2022 bën matjen nga 600 kWh dhe bëhet leximi me 4278 kWh (pra rikthehet në vlerat e matura në datën 27.07.2022). Me justifikimin e index-it të export-it të matësit të vjetër në vlerën 04278 kWh, FSHU sh.a, në mënyrë të parregullt lëshon/emeton Faturë Sistemuese – Notë Debiti, ku 3678 kWh i përlllogarit si konsum i pafaturuar, si dhe 100 TV tax, me një detyrim për t'u paguar në totalin prej 42,029.20 lekësh (në dhjetor 2024 debia e akumuluar arrin në vlerën 72,553.66 lekë, së bashku me kamatëvonesat).

Nëse do të ndiqej logjika e fundit e përlllogaritjes së detyrimit të emetuar me faturën sistemuese – notë debiti, duhej që në sistem të vazhdonte të rezultonte vlera e matur në momentin e mbajtjes së procesverbalit të datës 11.10.2022, më të dhënat e matësit të vjetër me nr. Serie 8027374, model induktiv, me Index Exporti aktive 1.8.5 kWh 04278 (ndërkohë sistemi mPower në 30.08.2022 dhe 30.09.2022 shfaq leximin 600 kWh). Pra, nëse në sistemin mPower do vazhdonte të shfaqej leximi real si ai i matësit në vlerën prej 4278 kWh, atëherë diferenca e momentit të demontimit (04278) me leximin në sistemin mPower 4278, do të ishte 0 (zero), që kuptohet që nuk ka dhe nuk qëndron konsum i pafaturuar.

Referuar ligjit nr.8662, datë 18.9.2000 “Për Trajtimin si Titull Ekzekutiv të Faturës së Konsumit të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 87, datë 18.12.2019 “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr 92, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, (ligj nr. 92/2014), përcaktohet se: “...çdo dokument në letër ose formë elektronike që ndryshon dhe i referohet në mënyrë specifike dhe të qartë faturës fillestare dhe që, për qëllime të këtij ligji, janë dokumentet e emërtuara si më poshtë: i)notë krediti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, për qëllim të një rregullimi në rritje të detyrimit të TVSH-së, pasi të jetë lëshuar fatura tatimore për atë furnizim të tatueshëm. ii)notë debiti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, për qëllim të një rregullimi në zbritje të detyrimit të TVSH-së, pasi të jetë lëshuar fatura tatimore për atë furnizim të tatueshëm.”⁶. Thënë kjo, shoqëria që ofron shërbimin e furnizimit universal (FSHU sha), në kuptim të ligjit nr. 92/2014, nga data 30.08.2022 dhe 30.09.2022 nuk i ka përlllogaritur në masën e duhur sasinë e dhënë të energjisë elektrike abonentit, dhe për këtë në datë datë 24.10.2022 FSHU sha justifikohet me një faturë sistemuese-notë debiti me një konsum energjie elektrike preja 3678 kWh duke e përlllogaritur si konsum të pafaturuar.

Në përfundim, në rastin konkret evidentohet se nuk është respektuar matja e enegjisë elektrike sipas parametrave dhe rregulloreve në fuqi, pasi ndër të tjera, logjika e matjes së konsumit të energjisë elektrike është progresive. Pra, konsumi i kësaj energjie të zbresë nga vlera 4277 kWh në vlerën prej 600 kWh, nuk mund të jetë i gjeneruar nga sistemi pa ndërhyrjen e parregullt nga dora e njeriut, më saktë nga personat përgjegjës të cilët kanë ushtruar detyrën pranë kësaj shoqërie. Që do të thotë është bërë manipulim i sistemit të matjes së energjisë

⁶ Neni 95 i ligjit nr. 92/2014

mPower. Kjo është mëse e vërtetueshme nga vlera që ka patur matësi, model induktiv, me nr serie 8027374, në momentin e demontimit, e cila nuk ka qenë 600 kWh (sikurse tregon sistemi mPower).

Në këto kushte, qartazi kuptohet se kemi të bëjmë me një rast të abuzimit dhe shpërdorimit të detyrës që ka passjellë kalimin e abonentit në gjendjen e debitorit, ku për më tepër, për më të shumtën e kohës, ai qëndron dhe banon në shtetin fqinj, në Greqi. Prandaj, ankuesi është cenuar në të drejtën e tij si konsumator, duke u debituar në mënyrë të parregullt e të padrejtë nëpërmjet lëshimit të një fature tatimore, e cila e ka vendosur në rrezikun e pagimit të një detyrimi që nuk duhet të ekzistojë. Sikurse parashikohet edhe në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, në pikën 1, të nenit 27 “Kushtet e padrejta”, parashikon se: *“1. Kushti kontraktual, i cili nuk është negociuar veçmas, është i padrejtë në qoftë se shkakton pabarazi të ndjeshme dhe të dallueshme në të drejtat dhe detyrimet e palëve, që rrjedhin nga kontrata, në dëm të konsumatorëve”*

Nga këto veprime, nën dritën e parimit të sigurisë juridike me të cilën nënkuptohet, veç të tjerash, besueshmëria e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara, është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Gjithashtu, është cenuar parimi i ligjshmërisë, i cili parashikohet në nenin 4, të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: *“Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca”*.

Shkelja e të drejtave të mësipërme dhe të cenimit të parimit të përgjegjësisë nga kjo shoqëri, me kapital 100% shtet, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së kësaj shoqërie me padi civile për dëmin që i është shkaktuar shtetasit, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura. Theksojmë se këto parime janë shumë të rëndësishme dhe që duhet të respektohen përgjatë gjithë veprimtarisë së organeve publike.

Bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për anulimin e faturës sistemuese-notë debiti ndaj z. V.G., të gjeneruar për periudhën 24.10.2022-30.10.2022, pasi është bërë manipulim i sistemit mPower në matjen e energjisë aktive nga periudha 30.08.2022 deri më 24.10.2022.
- Marrjen e masave lidhur me nxjerrjen e përgjegjësiave dhe evidentimin e personave që kanë çuar abonentin, z. V.G. në situatën debitor ndaj FSHU sh.a.
- Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen, duke mos respektuar të drejtat e shtetasve dhe konsumatorë fundorë të energjisë elektrike.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ *Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit* ”, nisur nga problematika e ngutshme, kërkojmë të vlerësoni këtë rekomandim në mënyrë të menjëhershme, dhe pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI